**Rregullorja (BE) 2019/1150 (P2B) — Tabela e përputhshmërisë**

*Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" — varianti i përpunuar, 14.9.2026*

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| **Neni 1 (1)**<br>**Objekti dhe fusha e zbatimit** | 1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të kontribuojë në funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, duke përcaktuar rregulla për të siguruar që përdoruesve të biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve në lidhje me motorët e kërkimit online t'u garantohen transparencë e përshtatshme, drejtësi dhe mundësi efektive kompensimi. | 01 | Neni 1, shkronja "a"; Neni 2, shkronja "a" | [Neni 1, shkronja "a"]<br>a) të kontribuojë në funksionimin e duhur të tregut të brendshëm në Republikën e Shqipërisë përmes rregullave që i sigurojnë përdoruesve biznes të shërbimeve ndërmjetëse online dhe përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve në lidhje me motorët e kërkimit, një mjedis të drejtë dhe transparent, si dhe mundësitë për mjete efektive.<br>[Neni 2, shkronja "a"]<br>a) përcaktimi i rregullave për promovimin e drejtësisë, transparencës dhe të mjeteve efektive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe për përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve në lidhje me motorët e kërkimit online, në përputhje me praktikën e Bashkimit Evropian dhe me angazhimin rajonal të parashikuar në nenin 20, të Vendimit nr. 2/2024 të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, të ratifikuar me ligjin nr. 50/2025; | F | |
| **Neni 1 (2)** | 2. Kjo Rregullore zbatohet për shërbimet e ndërmjetësimit online dhe për motorët e kërkimit online që u ofrohen, ose synohen t'u ofrohen, përkatësisht përdoruesve të biznesit dhe përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve, të cilët kanë vendin e themelimit ose vendbanimin në Bashkimin Evropian dhe që, | 01 | Neni 3, pika 1; Neni 4, pika 1, shkronja "l"; | [Neni 3, pika 1]<br>1. Ky ligj zbatohet për shërbimet e ndërmjetësimit online dhe për motorët e kërkimit online sipas përcaktimeve në krerët II, III, IV dhe V të këtij ligji, që u ofrohen ose synohen t'u ofrohen: | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | nëpërmjet këtyre shërbimeve të ndërmjetësimit online ose motorëve të kërkimit online, u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve të vendosur në Bashkimin Evropian, pavarësisht nga vendi i themelimit ose i banimit të ofruesve të këtyre shërbimeve dhe pavarësisht nga ligji që do të zbatohej ndryshe. | | | a) përdoruesve të biznesit dhe përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve që kanë vendin e themelimit ose vendbanimin në Republikën e Shqipërisë dhe që, nëpërmjet këtyre shërbimeve, u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve të vendosur në Republikën e Shqipërisë ose në një Palë tjetër të CEFTA-s; ose<br>b) përdoruesve të biznesit dhe përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve që kanë vendin e themelimit ose vendbanimin në një Palë tjetër të CEFTA-s dhe që, nëpërmjet këtyre shërbimeve, u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve të vendosur në Republikën e Shqipërisë.<br>[Neni 4, pika 1, shkronja "l"]<br>l) "Palë e CEFTA-s" është një palë e Marrëveshjes për Ndryshimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, për të cilën zbatohet Vendimi nr. 2/2024 i Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, sipas nenit 54 të atij vendimi; | | |
| **Neni 1 (3)** | 3. Kjo Rregullore nuk zbatohet për shërbimet e pagesave online ose për mjetet e reklamimit online ose shkëmbimet e reklamimit online, që nuk ofrohen me qëllim lehtësimin e nisjes së transaksioneve të drejtpërdrejta dhe që nuk përfshijnë marrëdhënie kontraktuale me konsumatorët. | 01 | Neni 3, pika 2; | 2. Ky ligj, për sa parashikon në krerët II, III, IV dhe V të tij, nuk zbatohet për:<br>a) shërbimet e pagesave online;<br>b) mjetet e publicitetit online dhe shkëmbimet e publicitetit online, që nuk ofrohen me qëllim lehtësimin e nisjes së transaksioneve direkte dhe që nuk përfshijnë marrëdhënie kontraktore me konsumatorët. | F | |
| **Neni 1 (4)** | 4. Kjo Rregullore nuk cenon rregullat kombëtare që, në përputhje me të drejtën e Bashkimit, ndalojnë ose sanksionojnë sjelljen njëanshme ose | 01 | Neni 3, pika 5; | 5. Ky ligj nuk cenon zbatimin e legjislacionit në fuqi që ndalon ose sanksionon praktikat e njëanshme ose të padrejta tregtare për çështje që | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | praktikat e padrejta tregtare, për aq sa aspektet përkatëse nuk mbulohen nga kjo Rregullore. Kjo Rregullore nuk prek të drejtën civile kombëtare, në veçanti të drejtën kontraktore, si rregullat për vlefshmërinë, lidhjen, efektet ose zgjidhjen e kontratës, për aq sa rregullat e së drejtës civile kombëtare janë në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe për aq sa aspektet përkatëse nuk mbulohen nga kjo Rregullore. | | | nuk rregullohen nga krerët II–V, të këtij ligji si dhe legjislacioni në fuqi për vlefshmërinë, lidhjen, efektet ose zgjidhjen e kontratës. | | |
| **Neni 1 (5)** | 5. Kjo Rregullore nuk cenon të drejtën e Bashkimit, në veçanti të drejtën e Bashkimit të zbatueshme në fushat e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile, të konkurrencës, të mbrojtjes së të dhënave, të mbrojtjes së sekreteve tregtare, të mbrojtjes së konsumatorëve, të tregtisë elektronike dhe të shërbimeve financiare. | 01 | Neni 3, pika 4; | 4. Ky ligj nuk cenon zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorëve, tregtinë elektronike, mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e sekretit tregtar dhe shërbimet financiare. | F | |
| **Neni 2 Përkufizime** | Për qëllimet e kësaj Rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme: | 01 | Neni 4, pika 1; | 1. Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: | F | |
| **Neni 2 (1)** | (1) "përdorues biznesi" është çdo person fizik që vepron në cilësinë e tregtarit ose në kuadër të një veprimtarie profesionale, ose çdo person juridik, që, nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online, u ofron mallra ose shërbime konsumatorëve për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "a"; | a) "përdorues biznesi" është çdo person fizik që vepron në cilësinë e tregtarit ose në kuadër të një veprimtarie profesionale, ose çdo person juridik që, nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online, u ofron mallra ose shërbime konsumatorëve për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij; | F | |
| **Neni 2 (2)** | (2) "shërbime ndërmjetësimi online" janë shërbimet që plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme: | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "b"; | b) "shërbim ndërmjetësimi online" është shërbimi që plotëson njëkohësisht këto kushte: | F | |
| **Neni 2 (2) (a)** | (a) përbëjnë shërbime të shoqërisë së informacionit në kuptim të shkronjës (b) të nenit | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "b", nënndarja "i" | i) përbën shërbim të shoqërisë së informacionit, në kuptim të ligjit nr. 10128, datë 11.5.2009, "Për tregtinë elektronike", të ndryshuar; | F | |

| Acquis i BE-së: **Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar** **01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (kreët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | 1(1) të Direktivës (BE) 2015/1535 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit; | | | | | |
| **Neni 2 (2) (b)** | (b) u mundësojnë përdoruesve të biznesit t'u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve, me qëllim lehtësimin e nisjes së transaksioneve të drejtpërdrejta ndërmjet këtyre përdoruesve të biznesit dhe konsumatorëve, pavarësisht nga vendi ku përfundojnë faktikisht këto transaksione; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "b", nënndarja "ii" | ii) u mundëson përdoruesve të biznesit t'u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve, me qëllim lehtësimin e nisjes së transaksioneve të drejtpërdrejta ndërmjet tyre, pavarësisht nga vendi ku përfundojnë faktikisht këto transaksione; | F | |
| **Neni 2 (2) (c)** | (c) u ofrohen përdoruesve të biznesit në bazë të marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet ofruesit të këtyre shërbimeve dhe përdoruesve të biznesit që u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "b", nënndarja "iii" | iii) u ofrohet përdoruesve të biznesit në bazë të një marrëdhënieje kontraktuale ndërmjet ofruesit të shërbimit dhe përdoruesit të biznesit; | F | |
| **Neni 2 (3)** | (3) "ofrues i shërbimeve të ndërmjetësimit online" është çdo person fizik ose juridik që ofron, ose synon të ofrojë, shërbime ndërmjetësimi online për përdoruesit e biznesit; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "c"; | c) "ofrues i shërbimeve të ndërmjetësimit online" është çdo person fizik ose juridik që ofron, ose synon të ofrojë, shërbime ndërmjetësimi online për përdoruesit e biznesit; | F | |
| **Neni 2 (4)** | (4) "konsumator" është çdo person fizik që vepron për qëllime që janë jashtë tregtisë, biznesit, zanatit ose profesionit të tij; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "ç"; | ç) "konsumator" ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve; | F | |
| **Neni 2 (5)** | (5) "motor kërkimi online" është një shërbim digjital që u mundëson përdoruesve të paraqesin kërkesa për të kryer kërkime, në parim, në të gjitha faqet e internetit ose në të gjitha faqet e internetit në një gjuhë të caktuar, mbi bazën e një kërkese për çdo temë, në formën e një fjale kyçe, kërkese me zë, fraze ose të dhëne tjetër, dhe që kthen rezultate në çdo format, në të cilin mund të gjendet informacioni që lidhet me përmbajtjen e kërkuar; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "d"; | d) "motor kërkimi online" është shërbimi digjital që u mundëson përdoruesve të paraqesin kërkesa për të kryer kërkime, në parim, në të gjitha faqet e internetit ose në të gjitha faqet e internetit në një gjuhë të caktuar, mbi bazën e një kërkese për çdo temë, në formën e një fjale kyçe, kërkese me zë, fraze ose të dhëne tjetër, dhe që kthen rezultate në çdo format, në të cilin mund të gjendet informacioni i kërkuar; | F | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| **Neni 2 (6)** | (6) "ofrues i motorit të kërkimit online" është çdo person fizik ose juridik që ofron, ose synon të ofrojë, motorë kërkimi online për konsumatorët; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "dh"; | dh) "ofrues i motorit të kërkimit online" është çdo person fizik ose juridik që ofron, ose synon të ofrojë, motorë kërkimi online për konsumatorët; | F | |
| **Neni 2 (7)** | (7) "përdorues i faqes së internetit të ndërmarrjes" është çdo person fizik ose juridik që përdor një ndërfaqe online, domethënë çdo program, përfshirë një faqe interneti ose një pjesë të saj dhe aplikacione, përfshirë aplikacionet për pajisje të lëvizshme, për t'u ofruar mallra ose shërbime konsumatorëve për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "e"; | e) "përdorues i faqes së internetit të ndërmarrjes" është çdo person fizik ose juridik që përdor një ndërfaqe online, përfshirë faqen e internetit ose një pjesë të saj dhe aplikacionet, përfshirë aplikacionet për pajisjet e lëvizshme, për t'u ofruar mallra ose shërbime konsumatorëve për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij; | F | |
| **Neni 2 (8)** | (8) "renditje" është rëndësia relative që u jepet mallrave ose shërbimeve të ofruara nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online, ose rëndësia që u jepet rezultateve të kërkimit nga motorët e kërkimit online, ashtu siç paraqiten, organizohen ose komunikohen përkatësisht nga ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online ose nga ofruesit e motorëve të kërkimit online, pavarësisht nga mjetet teknologjike të përdorura për këtë paraqitje, organizim ose komunikim; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "ë"; | ë) "renditje" është rëndësia relative që u jepet mallrave ose shërbimeve të ofruara nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online, ose rëndësia që u jepet rezultateve të kërkimit nga motorët e kërkimit online, ashtu siç paraqiten, organizohen ose komunikohen nga ofruesi, pavarësisht nga mjetet teknologjike të përdorura për këtë paraqitje, organizim ose komunikim; | F | |
| **Neni 2 (9)** | (9) "kontroll" është pronësia ose aftësia për të ushtruar ndikim vendimtar mbi një ndërmarrje, në kuptim të nenit 3(2) të Rregullores (KE) nr. 139/2004 të Këshillit; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "f"; | f) "kontroll" është pronësia ose aftësia për të ushtruar ndikim vendimtar mbi një ndërmarrje, në kuptimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës; | F | |
| **Neni 2 (10)** | (10) "kushte të përgjithshme" janë të gjitha kushtet ose specifikimet, pavarësisht nga emërtimi ose forma e tyre, që rregullojnë marrëdhënien kontraktuale ndërmjet ofruesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesve të tij të biznesit dhe që përcaktohen njëanshmërisht nga ofruesi i shërbimeve të | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "g"; | g) "termat dhe kushtet" janë të gjitha kushtet, klauzolat ose specifikimet, pavarësisht nga emërtimi ose forma e tyre, që rregullojnë marrëdhënien kontraktuale ndërmjet ofruesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesit të biznesit dhe që përcaktohen njëanshmërisht nga ofruesi. Karakteri | F | |

| Acquis i BE-së: **Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar** **01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | ndërmjetësimit online, ku ky përcaktim njëanshëm vlerësohet mbi bazën e një vlerësimi të përgjithshëm, për të cilin madhësia relative e palëve në fjalë, fakti se është zhvilluar një negociatë ose se disa dispozita të tyre mund t'i jenë nënshtruar një negociate të tillë dhe janë përcaktuar bashkërisht nga ofruesi dhe përdoruesi i biznesit përkatës nuk janë, në vetvete, vendimtare; | | | njëanshëm vlerësohet rast pas rasti, mbi bazën e një vlerësimi të përgjithshëm, ku madhësia relative e palëve, fakti se është zhvilluar një negociatë ose se disa dispozita janë negociuar dhe përcaktuar bashkërisht nuk janë, në vetvete, vendimtare; | | |
| **Neni 2 (11)** | (11) "mallra dhe shërbime ndihmëse" janë mallrat dhe shërbimet që i ofrohen konsumatorit përpara përfundimit të një transaksioni të nisur në shërbimet e ndërmjetësimit online, si shtesë dhe plotësim i mallit ose shërbimit kryesor të ofruar nga përdoruesi i biznesit nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "gj"; | gj) "mallra dhe shërbime ndihmëse" janë mallrat dhe shërbimet që i ofrohen konsumatorit përpara përfundimit të një transaksioni të nisur në shërbimin e ndërmjetësimit online, si plotësim i mallit ose i shërbimit kryesor të ofruar nga përdoruesi i biznesit nëpërmjet këtij shërbimi; | F | |
| **Neni 2 (12)** | (12) "ndërmjetësim" është çdo proces i strukturuar, siç përkufizohet në shkronjën (a) të nenit 3 të Direktivës 2008/52/KE; | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "h"; | h) "ndërmjetësim" ka kuptimin e dhënë në ligjin në fuqi për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; | F | |
| **Neni 2 (13)** | (13) "mjet i qëndrueshëm" është çdo instrument që u mundëson përdoruesve të biznesit të ruajnë informacionin që u drejtohet personalisht, në mënyrë të qasshme për referim të mëvonshëm dhe për një periudhë kohore të përshtatshme me qëllimet e informacionit, dhe që lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur. | 01 | Neni 4, pika 1, shkronja "i"; | i) "medium i qëndrueshëm" është çdo instrument që i mundëson përdoruesit të biznesit të ruajë informacionin që i drejtohet personalisht, në mënyrë që të aksesohet për referim të mëvonshëm dhe për një periudhë kohore të përshtatshme me qëllimet e informacionit, dhe që lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur; | F | |
| **Neni 3 (1) Kushtet e përgjithshme** | 1. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online sigurojnë që kushtet e tyre të përgjithshme: | 01 | Neni 6, pika 1; | 1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online siguron që kushtet e tij të përgjithshme: | F | |
| **Neni 3 (1) (a)** | (a) të jenë hartuar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme; | 01 | Neni 6, pika 1, shkronja "a"; | Neni 6 | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | | | Neni 6, pika 2; | 1/a) të jenë hartuar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme;<br>2. Kushtet e përgjithshme hartohen në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme që i mundësojnë përdoruesit mesatar të biznesit të kuptojë të drejtat, detyrimet dhe pasojat kryesore të marrëdhënies kontraktuale. Formulimet e paqarta, tepër të përgjithshme, mashtruese ose pa hollësitë e nevojshme për çështje të rëndësishme tregtare nuk e përmbushin këtë kërkesë. | | |
| **Neni 3 (1) (b)** | (b) të jenë lehtësisht të disponueshme për përdoruesit e biznesit në të gjitha fazat e marrëdhënies së tyre tregtare me ofruesin e shërbimeve të ndërmjetësimit online, përfshirë fazën parakontraktuale; | 01 | Neni 6, pika 1, shkronja "b"; | b) të jenë lehtësisht të disponueshme për përdoruesit e biznesit në të gjitha fazat e marrëdhënies së tyre tregtare me ofruesin, përfshirë fazën parakontore; | F | |
| **Neni 3 (1) (c)** | (c) të përcaktojnë arsyet për vendimet për pezullimin, ndërprerjen ose vendosjen e çdo lloj kufizimi tjetër, tërësisht ose pjesërisht, mbi ofrimin e shërbimeve të tyre të ndërmjetësimit online ndaj përdoruesve të biznesit; | 01 | Neni 6, pika 1, shkronja "c"; | c) të përcaktojnë arsyet për vendimet për pezullimin, ndërprerjen ose vendosjen e çdo lloj kufizimi tjetër, tërësisht ose pjesërisht, mbi ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online ndaj përdoruesve të biznesit; | F | |
| **Neni 3 (1) (d)** | (d) të përfshijnë informacion për çdo kanal shtesë shpërndarjeje dhe për çdo program të mundshëm bashkëpunimi, nëpërmjet të cilave ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online mund të tregtojnë mallrat dhe shërbimet e ofruara nga përdoruesit e biznesit; | 01 | Neni 6, pika 1, shkronja "ç" | ç) të përfshijnë informacion për çdo kanal shtesë shpërndarjeje dhe për çdo program të mundshëm bashkëpunimi, nëpërmjet të cilave ofruesi mund të tregtojë mallrat dhe shërbimet e ofruara nga përdoruesit e biznesit; | F | |
| **Neni 3 (1) (e)** | (e) të përfshijnë informacion të përgjithshëm për efektet e kushteve të përgjithshme mbi pronësinë dhe kontrollin e të drejtave të pronësisë intelektuale të përdoruesve të biznesit. | 01 | Neni 6, pika 1, shkronja "d" | d) të përfshijnë informacion të përgjithshëm për efektet e kushteve të përgjithshme mbi pronësinë dhe kontrollin e të drejtave të pronësisë intelektuale të përdoruesve të biznesit. | F | |

| Acquis i BE-së:<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| **Neni 3 (2)** | 2. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online njoftojnë, në një mjet të qëndrueshëm, përdoruesit e biznesit të prekur për çdo ndryshim të propozuar të kushteve të tyre të përgjithshme.<br>Ndryshimet e propozuara nuk zbatohen përpara skadimit të një afati njoftimi që është i arsyeshëm dhe proporcional me natyrën dhe shkallën e ndryshimeve të parashikuara dhe me pasojat e tyre për përdoruesin e biznesit të prekur. Ky afat njoftimi është të paktën 15 ditë nga data në të cilën ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online njofton përdoruesit e biznesit të prekur për ndryshimet e propozuara. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online japin afate njoftimi më të gjata kur kjo është e nevojshme për t'u mundësuar përdoruesve të biznesit të bëjnë përshtatje teknike ose tregtare për t'u përputhur me ndryshimet.<br>Përdoruesi i biznesit i prekur ka të drejtë ta zgjidhë kontratën me ofruesin e shërbimeve të ndërmjetësimit online përpara skadimit të afatit të njoftimit. Kjo zgjidhje prodhon efekte brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit sipas nënparagrafit të parë, përveç kur për kontratën zbatohet një afat më i shkurtër.<br>Përdoruesi i biznesit i prekur mund të heqë dorë, me deklaratë me shkrim ose me veprim të qartë konfirmues, nga afati i njoftimit i përmendur në nënparagrafin e dytë, në çdo moment nga marrja e njoftimit sipas nënparagrafit të parë.<br>Gjatë afatit të njoftimit, paraqitja e mallrave ose e shërbimeve të reja në shërbimet e ndërmjetësimit online konsiderohet veprim i qartë konfirmues për heqjen dorë nga afati i njoftimit, përveç rasteve kur afati i arsyeshëm dhe proporcional i njoftimit | 01 | Neni 7, pika 1; Neni 7, pika 2; Neni 7, pika 3; Neni 7, pika 4; | 1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online njofton, në një medium të qëndrueshëm, përdoruesit e biznesit të prekur për çdo ndryshim të propozuar të kushteve të përgjithshme.<br>2. Ndryshimet e propozuara nuk zbatohen përpara skadimit të një afati njoftimi që është i arsyeshëm dhe proporcional me natyrën dhe shkallën e ndryshimeve të parashikuara dhe me pasojat e tyre për përdoruesin e biznesit. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga data në të cilën ofruesi njofton përdoruesit e biznesit për ndryshimet e propozuara. Kur ndryshimet e propozuara kërkojnë nga përdoruesi i biznesit të bëjë përshtatje teknike ose tregtare të rëndësishme, jepen afate njoftimi më të gjata.<br>3. Përdoruesi i biznesit ka të drejtë të zgjidhë kontratën me ofruesin përpara skadimit të afatit të njoftimit. Zgjidhja prodhon efekte brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit sipas pikës 1 të këtij neni, përveç kur për kontratën zbatohet një afat më i shkurtër.<br>4. Përdoruesi i biznesit mund të heqë dorë nga afati i njoftimit i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, në çdo kohë pas marrjes së njoftimit, me deklaratë me shkrim ose me veprim të qartë konfirmues. Paraqitja e mallrave ose e shërbimeve të reja në shërbimin e ndërmjetësimit online gjatë afatit të njoftimit konsiderohet veprim i qartë konfirmues për heqjen dorë nga afati i njoftimit, përveç rastit kur afati i arsyeshëm dhe proporcional i njoftimit është më i gjatë se 15 ditë, për shkak se | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | është më i gjatë se 15 ditë, sepse ndryshimet e kushteve të përgjithshme kërkojnë nga përdoruesi i biznesit të bëjë përshtatje teknike të rëndësishme të mallrave ose shërbimeve të tij. Në raste të tilla, afati i njoftimit nuk konsiderohet automatikisht i hequr dorë kur përdoruesi i biznesit paraqet mallra dhe shërbime të reja. | | | ndryshimet e kushteve të përgjithshme kërkojnë nga përdoruesi i biznesit përshtatje teknike të rëndësishme të mallrave ose të shërbimeve të tij. | | |
| **Neni 3 (3)** | 3. Kushtet e përgjithshme, ose dispozita të veçanta të tyre, që nuk përmbushin kërkesat e paragrafit 1, si dhe ndryshimet e kushteve të përgjithshme të zbatuara nga një ofrues i shërbimeve të ndërmjetësimit online në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 2, janë të pavlefshme. | 01 | Neni 6, pika 4; Neni 7, pika 6 | [Neni 6, pika 4]<br>4. Kushtet e përgjithshme ose dispozitat e veçanta të tyre që nuk përmbushin kërkesat e pikës 1, të këtij neni janë absolutisht të pavlefshme dhe konsiderohen sikur nuk kanë ekzistuar. Pavlefshmëria përfshin vetëm dispozitat që nuk i përmbushin këto kërkesa; pjesa tjetër e kushteve të përgjithshme mbetet e vlefshme dhe e zbatueshme, nëse mund të veçohet prej tyre.<br>[Neni 7, pika 6]<br>6. Ndryshimet e kushteve të përgjithshme, të zbatuara nga ofruesi në kundërshtim me këtë nen, janë absolutisht të pavlefshme. | F | |
| **Neni 3 (4)** | 4. Afati i njoftimit i përcaktuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit 2 nuk zbatohet kur një ofrues i shërbimeve të ndërmjetësimit online: | 01 | Neni 7, pika 5 | 5. Afati i njoftimit i parashikuar në pikën 2, të këtij neni nuk zbatohet kur ofruesi: | F | |
| **Neni 3 (4) (a)** | (a) i nënshtrohet një detyrimi ligjor ose rregullator, që e detyron t'i ndryshojë kushtet e tij të përgjithshme në një mënyrë që nuk i lejon të respektojë afatin e njoftimit të përmendur në nënparagrafin e dytë të paragrafit 2; | 01 | Neni 7, pika 5, shkronja "a" | a) i nënshtrohet një detyrimi ligjor ose rregullator, që e detyron ta ndryshojë kushtet e tij të përgjithshme në një mënyrë që nuk i lejon të respektojë afatin e njoftimit; | F | |
| **Neni 3 (4) (b)** | (b) duhet t'i ndryshojë përjashtimisht kushtet e tij të përgjithshme për t'u përballur me një rrezik të paparashikuar dhe të menjëhershëm, që lidhet me | 01 | Neni 7, pika 5, shkronja "b" | b) duhet t'i ndryshojë përjashtimisht kushtet e tij të përgjithshme për t'u përballur me një rrezik të paparashikuar dhe të menjëhershëm, që lidhet | F | |

| Acquis i BE-së:<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | Legjislacioni shqiptar i propozuar<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | mbrojtjen e shërbimeve të ndërmjetësimit online, të konsumatorëve ose të përdoruesve të biznesit nga mashtrimi, programet keqdashëse, mesazhet e padëshiruara, shkeljet e të dhënave ose rreziqe të tjera për sigurinë kibernetike. | | | me mbrojtjen e shërbimit të ndërmjetësimit online, të konsumatorëve ose të përdoruesve të biznesit nga mashtrimi, programet keqdashëse, mesazhet e padëshiruara, shkeljet e të dhënave ose nga rreziqe të tjera për sigurinë kibernetike. | | |
| **Neni 3 (5)** | 5. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online sigurojnë që identiteti i përdoruesit të biznesit, që ofron mallrat ose shërbimet në shërbimet e ndërmjetësimit online, të jetë qartësisht i dukshëm. | 01 | Neni 6, pika 3 | 3. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online siguron që identiteti i përdoruesit të biznesit që ofron mallra ose shërbime nëpërmjet shërbimit të ndërmjetësimit online të jetë qartësisht i dukshëm. | F | |
| **Neni 4 (1)**<br>**Kufizimi, pezullimi dhe ndërprerja** | 1. Kur një ofrues i shërbimeve të ndërmjetësimit online vendos të kufizojë ose të pezullojë ofrimin e shërbimeve të tij të ndërmjetësimit online ndaj një përdoruesi biznesi të caktuar, në lidhje me mallra ose shërbime të veçanta të ofruara nga ky përdorues biznesi, ai i jep përdoruesit të biznesit të prekur, përpara ose në momentin e hyrjes në fuqi të kufizimit ose të pezullimit, një deklaratë me arsyet e këtij vendimi në një mjet të qëndrueshëm. | 01 | Neni 8, pika 1 | 1. Kur ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online vendos të kufizojë ose të pezullojë ofrimin e shërbimeve të tij për një përdorues biznesi të caktuar, në lidhje me mallra ose shërbime të veçanta të ofruara nga ky përdorues, ai i jep përdoruesit të biznesit, përpara ose në çastin e fillimit të zbatimit të kufizimit ose të pezullimit, një deklaratë me arsyet e vendimit, në një mjet të qëndrueshëm. | F | |
| **Neni 4 (2)** | 2. Kur një ofrues i shërbimeve të ndërmjetësimit online vendos të ndërpresë ofrimin e të gjitha shërbimeve të tij të ndërmjetësimit online ndaj një përdoruesi biznesi të caktuar, ai i jep përdoruesit të biznesit të prekur, të paktën 30 ditë përpara hyrjes në fuqi të ndërprerjes, një deklaratë me arsyet e këtij vendimi në një mjet të qëndrueshëm. | 01 | Neni 8, pika 2 | 2. Kur ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online vendos të ndërpresë ofrimin e të gjitha shërbimeve të tij për një përdorues biznesi të caktuar, ai i jep përdoruesit të biznesit, të paktën 30 ditë përpara fillimit të zbatimit të ndërprerjes, një deklaratë me arsyet e vendimit, në një mjet të qëndrueshëm. | F | |
| **Neni 4 (3)** | 3. Në rastin e kufizimit, të pezullimit ose të ndërprerjes, ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online i jep përdoruesit të biznesit mundësinë të sqarojë faktet dhe rrethanat në kuadër të procesit të brendshëm të trajtimit të ankesave të përmendur në nenin 11. Kur kufizimi, | 01 | Neni 8, pika 3 | 3. Në rastet e kufizimit, pezullimit ose ndërprerjes, ofruesi i jep përdoruesit të biznesit mundësinë të sqarojë faktet dhe rrethanat në kuadër të sistemit të brendshëm të trajtimit të ankesave, sipas nenit 15, të këtij ligji. Kur masa revokohet, ofruesi e rikthen pa vonesë të | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | pezullimi ose ndërprerja revokohet nga ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online, ai e rivendos përdoruesin e biznesit pa vonesë të paarsyeshme, përfshirë duke i dhënë përdoruesit të biznesit çdo qasje në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, që kanë rezultuar nga përdorimi i shërbimeve përkatëse të ndërmjetësimit online përpara hyrjes në fuqi të kufizimit, pezullimit ose ndërprerjes. | | | pajustifikuar përdoruesin e biznesit në gjendjen e mëparshme, duke i mundësuar qasjen në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, të gjeneruara nga përdorimi i shërbimeve përpara fillimit të zbatimit të masës. | | |
| **Neni 4 (4)** | 4. Afati i njoftimit i paragrafit 2 nuk zbatohet kur një ofrues i shërbimeve të ndërmjetësimit online: | 01 | Neni 8, pika 4 | 4. Afati i njoftimit i parashikuar në pikën 2 të këtij neni nuk zbatohet kur ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online: | F | |
| **Neni 4 (4) (a)** | (a) i nënshtrohet një detyrimi ligjor ose rregullator, që e detyron të ndërpresë ofrimin e të gjitha shërbimeve të tij të ndërmjetësimit online ndaj një përdoruesi biznesi të caktuar, në një mënyrë që nuk i lejon të respektojë këtë afat njoftimi; ose | 01 | Neni 8, pika 4, shkronja "a" | a) i nënshtrohet një detyrimi ligjor ose rregullator, që e detyron të ndërpresë ofrimin e të gjitha shërbimeve të tij të ndërmjetësimit online për një përdorues biznesi të caktuar, në një mënyrë që nuk i lejon të respektojë këtë afat; | F | |
| **Neni 4 (4) (b)** | (b) ushtron një të drejtë ndërprerjeje për një arsye imperative sipas së drejtës kombëtare, që është në përputhje me të drejtën e Bashkimit; | 01 | Neni 8, pika 4, shkronja "b" | b) ushtron një të drejtë ndërprerjeje për një arsye imperative, sipas legjislacionit në fuqi; | F | |
| **Neni 4 (4) (c)** | (c) mund të provojë se përdoruesi i biznesit i prekur ka shkelur në mënyrë të përsëritur kushtet e përgjithshme të zbatueshme, çka ka sjellë ndërprerjen e ofrimit të të gjitha shërbimeve të ndërmjetësimit online në fjalë.<br>Në rastet kur afati i njoftimit i paragrafit 2 nuk zbatohet, ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online i jep përdoruesit të biznesit të prekur, pa vonesë të paarsyeshme, një deklaratë me arsyet e këtij vendimi në një mjet të qëndrueshëm. | 01 | Neni 8, pika 4, shkronja "c"; Neni 8, pika 4; | c) mund të provojë se përdoruesi i biznesit në fjalë ka shkelur në mënyrë të përsëritur kushtet e përgjithshme të zbatueshme, çka ka sjellë ndërprerjen e ofrimit të të gjitha shërbimeve të ndërmjetësimit online në fjalë.<br>Në rastet e parashikuara në këtë pikë, ofruesi i jep përdoruesit të biznesit, pa vonesë të pajustifikuar, deklaratën me arsyet e vendimit, në një medium të qëndrueshëm. | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| **Neni 4 (5)** | 5. Deklarata me arsyet e përmendur në paragrafët 1 dhe 2 dhe në nënparagrafin e dytë të paragrafit 4 përmban një referim në faktet ose rrethanat konkrete, përfshirë përmbajtjen e njoftimeve të palëve të treta, që kanë çuar në vendimin e ofruesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online, si dhe një referim në arsyet e zbatueshme për këtë vendim, të përmendura në shkronjën (c) të nenit 3(1).<br>Një ofrues i shërbimeve të ndërmjetësimit online nuk është i detyruar të japë deklaratën me arsyet kur i nënshtrohet një detyrimi ligjor ose rregullator për të mos dhënë faktet ose rrethanat konkrete ose referimin në arsyen a arsyet e zbatueshme, ose kur ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online mund të provojë se përdoruesi i biznesit i prekur ka shkelur në mënyrë të përsëritur kushtet e përgjithshme të zbatueshme, çka ka sjellë ndërprerjen e ofrimit të të gjitha shërbimeve të ndërmjetësimit online në fjalë. | 01 | Neni 8, pika 5; | 5. Deklarata me arsyet, e parashikuar në pikat 1, 2 dhe 4 të këtij neni, përmban referimin në faktet ose rrethanat konkrete, përfshirë përmbajtjen e njoftimeve të palëve të treta, që kanë çuar në vendimin e ofruesit, si dhe referimin në arsyet e zbatueshme për këtë vendim, të parashikuara në kushtet e përgjithshme sipas nenit 6, pika 1, shkronja "c", të këtij ligji. Ofruesi nuk është i detyruar të japë deklaratën me arsyet kur i nënshtrohet një detyrimi ligjor ose rregullator për të mos zbuluar faktet ose rrethanat konkrete a referimin në arsyet e zbatueshme, ose kur mund të provojë se përdoruesi i biznesit ka shkelur në mënyrë të përsëritur kushtet e përgjithshme të zbatueshme. | F | |
| **Neni 5 (1)**<br>**Renditja** | 1. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online përcaktojnë në kushtet e tyre të përgjithshme parametrat kryesorë që përcaktojnë renditjen dhe arsyet e rëndësisë relative të këtyre parametrave kryesorë në krahasim me parametrat e tjerë. | 01 | Neni 10, pika 1; | 1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online përcakton në kushtet e tij të përgjithshme parametrat kryesorë që përcaktojnë renditjen, si dhe arsyet e rëndësisë relative të këtyre parametrave kryesorë në krahasim me parametrat e tjerë. | F | |
| **Neni 5 (2)** | 2. Ofruesit e motorëve të kërkimit online përcaktojnë parametrat kryesorë që, veçmas ose së bashku, janë më të rëndësishëm për përcaktimin e renditjes, dhe rëndësinë relative të këtyre parametrave kryesorë, duke vënë në dispozicion, në motorët e kërkimit online të këtyre ofruesve, një përshkrim lehtësisht dhe | 01 | Neni 10, pika 2; | 2. Ofruesi i motorit të kërkimit online përcakton parametrat kryesorë që, veçmas ose së bashku, janë më të rëndësishëm për përcaktimin e renditjes, si dhe rëndësinë relative të tyre, duke vënë në dispozicion të publikut, në motorin e tij të kërkimit online, një përshkrim lehtësisht të aksesueshëm, të hartuar në gjuhë të thjeshtë dhe | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | publikisht të qasshëm, të hartuar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Ata e mbajnë të përditësuar këtë përshkrim. | | | të kuptueshme. Ofruesi e mban të përditësuar këtë përshkrim. | | |
| **Neni 5 (3)** | 3. Kur parametrat kryesorë përfshijnë mundësinë e ndikimit mbi renditjen kundrejt çdo shpërblimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të paguar nga përdoruesit e biznesit ose nga përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve te ofruesi përkatës, ky ofrues paraqet edhe një përshkrim të këtyre mundësive dhe të efekteve të këtij shpërblimi mbi renditjen, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2. | 01 | Neni 10, pika 3; | 3. Kur parametrat kryesorë përfshijnë mundësinë e ndikimit mbi renditjen kundrejt çdo shpërblimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të paguar nga përdoruesit e biznesit ose nga përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve te ofruesi përkatës, ofruesi paraqet edhe një përshkrim të kësaj mundësie dhe të efekteve që ka ky shpërblim mbi renditjen, në përputhje me kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni. | F | |
| **Neni 5 (4)** | 4. Kur një ofrues i motorit të kërkimit online ka ndryshuar rendin e renditjes në një rast të caktuar ose ka hequr nga lista një faqe interneti të caktuar pas një njoftimi të palës së tretë, ofruesi i ofron përdoruesit të faqes së internetit të ndërmarrjes mundësinë të shqyrtojë përmbajtjen e njoftimit. | 01 | Neni 10, pika 4; | 4. Kur ofruesi i motorit të kërkimit online në një rast të caktuar ka ndryshuar renditjen,ose ka hequr nga lista e rezultateve një faqe interneti të caktuar, pas një njoftimi të palës së tretë, ai i ofron përdoruesit të faqes së internetit të ndërmarrjes mundësinë të shqyrtojë përmbajtjen e njoftimit. | F | |
| **Neni 5 (5)** | 5. Përshkrimet e përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 janë të mjaftueshme për t'u mundësuar përdoruesve të biznesit ose përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve të kuptojnë në mënyrë të përshtatshme nëse, dhe kur po, si dhe në çfarë mase mekanizmi i renditjes merr parasysh sa vijon: | 01 | Neni 10, pika 5; | 5. Përshkrimet e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni janë të mjaftueshme për t'u mundësuar përdoruesve të biznesit ose përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve të kuptojnë në mënyrë të përshtatshme nëse dhe, kur po, në ç'mënyrë dhe në ç'masë mekanizmi i renditjes merr parasysh: | F | |
| **Neni 5 (5) (a)** | (a) karakteristikat e mallrave dhe të shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online ose të motorit të kërkimit online; | 01 | Neni 10, pika 5, shkronja "a"; | a) karakteristikat e mallrave dhe të shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online ose të motorit të kërkimit online; | F | |
| **Neni 5 (5) (b)** | (b) rëndësinë e këtyre karakteristikave për këta konsumatorë; | 01 | Neni 10, pika 5, shkronja "b"; | b) rëndësinë e këtyre karakteristikave për konsumatorët; | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| **Neni 5 (5) (c)** | (c) për sa u përket motorëve të kërkimit online, karakteristikat e strukturës së faqes së internetit të përdorur nga përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve. | 01 | Neni 10, pika 5, shkronja "c"; | c) për motorët e kërkimit online, karakteristikat e strukturës së faqes së internetit të përdorur nga përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve. | F | |
| **Neni 5 (6)** | 6. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe ofruesit e motorëve të kërkimit online, në përmbushjen e kërkesave të këtij neni, nuk janë të detyruar të zbulojnë algoritmet ose çdo informacion që, me siguri të arsyeshme, do të mundësonte mashtrimin e konsumatorëve ose dëmtimin e tyre nëpërmjet manipulimit të rezultateve të kërkimit. Ky nen nuk cenon Direktivën (BE) 2016/943. | 01 | Neni 10, pika 6; | 6. Në përmbushjen e kërkesave të këtij neni, ofruesi nuk është i detyruar të zbulojë algoritmet ose çdo informacion që, me siguri të arsyeshme, do të mundësonte mashtrimin ose dëmtimin e konsumatorëve nëpërmjet manipulimit të rezultateve të kërkimit. Ky nen nuk cenon zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e sekretit tregtar. | F | Referim te legjislacioni për mbrojtjen e sekretit tregtar. |
| **Neni 5 (7)** | 7. Për të lehtësuar përmbushjen nga ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe ofruesit e motorëve të kërkimit online të kërkesave të këtij neni dhe zbatimin e tyre, Komisioni i shoqëron kërkesat e transparencës të përcaktuara në këtë nen me udhëzime. | — | — | — | NA | Kompetencë e Komisionit (udhëzime). |
| **Neni 6**<br>**Mallrat dhe shërbimet ndihmëse** | Kur mallra dhe shërbime ndihmëse, përfshirë produktet financiare, u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online, qoftë nga ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online, qoftë nga palë të treta, ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online përcakton në kushtet e tij të përgjithshme një përshkrim të llojit të mallrave dhe të shërbimeve ndihmëse që ofrohen dhe një përshkrim nëse dhe në cilat kushte përdoruesit të biznesit i lejohet gjithashtu të ofrojë mallrat ose shërbimet e tij ndihmëse nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit online. | 01 | Neni 11 | Kur mallra dhe shërbime ndihmëse, përfshirë shërbimet financiare, u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet shërbimit të ndërmjetësimit online, qoftë nga vetë ofruesi i shërbimit, qoftë nga palë të treta, ofruesi përcakton në kushtet e tij të përgjithshme llojin e mallrave dhe të shërbimeve ndihmëse që ofrohen, si dhe nëse dhe në cilat kushte përdoruesit të biznesit i lejohet të ofrojë mallrat ose shërbimet e veta ndihmëse nëpërmjet shërbimit të ndërmjetësimit online. | F | |
| **Neni 7 (1)** | 1. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online përfshijnë në kushtet e tyre të përgjithshme një | 01 | Neni 12, pika 1 | 1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online përfshin në kushtet e tij të përgjithshme një | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| **Trajtimi i diferencuar** | përshkrim të çdo trajtimi të diferencuar që japin, ose mund të japin, në lidhje me mallrat ose shërbimet që u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet këtyre shërbimeve të ndërmjetësimit online, nga njëra anë, nga vetë ofruesi ose nga çdo përdorues biznesi që ai kontrollon dhe, nga ana tjetër, nga përdoruesit e tjerë të biznesit. Ky përshkrim u referohet konsideratave kryesore ekonomike, tregtare ose ligjore për këtë trajtim të diferencuar. | | | përshkrim të çdo trajtimi të diferencuar që ofron, ose mund të ofrojë, ndërmjet mallrave ose shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet këtyre shërbimeve, nga njëra anë, nga vetë ofruesi ose nga përdoruesit e biznesit që ai kontrollon, dhe, nga ana tjetër, nga përdoruesit e tjerë të biznesit. Përshkrimi u referohet konsideratave kryesore ekonomike, tregtare ose ligjore për këtë trajtim të diferencuar. | | |
| **Neni 7 (2)** | 2. Ofruesit e motorëve të kërkimit online paraqesin një përshkrim të çdo trajtimi të diferencuar që japin, ose mund të japin, në lidhje me mallrat ose shërbimet që u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet këtyre motorëve të kërkimit online, nga njëra anë, nga vetë ofruesi ose nga çdo përdorues i faqes së internetit të ndërmarrjes që ai kontrollon dhe, nga ana tjetër, nga përdoruesit e tjerë të faqeve të internetit të ndërmarrjeve. | 01 | Neni 12, pika 2 | 2. Ofruesi i motorit të kërkimit online paraqet një përshkrim të çdo trajtimi të diferencuar që ofron, ose mund të ofrojë, ndërmjet mallrave ose shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve nëpërmjet motorit të kërkimit online, nga njëra anë, nga vetë ofruesi ose nga përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve që ai kontrollon, dhe, nga ana tjetër, nga përdoruesit e tjerë të faqeve të internetit të ndërmarrjeve. | F | |
| **Neni 7 (3)** | 3. Përshkrimet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 mbulojnë në veçanti, kur është rasti, çdo trajtim të diferencuar nëpërmjet masave të veçanta të marra nga ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online ose i motorit të kërkimit online, ose nëpërmjet sjelljes së tij, që lidhet me ndonjë nga sa vijon: | 01 | Neni 12, pika 3 | 3. Përshkrimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni mbulojnë, në veçanti, kur është rasti, çdo trajtim të diferencuar nëpërmjet masave të veçanta të marra nga ofruesi ose nëpërmjet sjelljes së tij, që lidhet me: | F | |
| **Neni 7 (3) (a)** | (a) qasjen që ofruesi, ose përdoruesit e biznesit a përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve që ai kontrollon, mund të kenë në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, që përdoruesit e biznesit, përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve ose konsumatorët japin për përdorimin e shërbimeve të ndërmjetësimit | 01 | Neni 12, pika 3, shkronja "a" | a) qasjen që ofruesi, ose përdoruesit e biznesit a përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve që ai kontrollon, mund të kenë në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, që përdoruesit e biznesit, përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve ose konsumatorët japin për përdorimin e shërbimit të | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | online ose të motorëve të kërkimit online përkatës, ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve; | | | ndërmjetësimit online ose të motorit të kërkimit online, ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve; | | |
| **Neni 7 (3) (b)** | (b) renditjen ose cilësimet e tjera të zbatuara nga ofruesi, që ndikojnë në qasjen e konsumatorëve në mallrat ose shërbimet e ofruara nëpërmjet këtyre shërbimeve të ndërmjetësimit online nga përdorues të tjerë biznesi ose nëpërmjet këtyre motorëve të kërkimit online nga përdorues të tjerë të faqeve të internetit të ndërmarrjeve; | 01 | Neni 12, pika 3, shkronja "b" | b) renditjen ose cilësimet e tjera të zbatuara nga ofruesi, që ndikojnë në qasjen e konsumatorëve në mallrat ose shërbimet e ofruara nga përdoruesit e tjerë të biznesit ose nga përdoruesit e tjerë të faqeve të internetit të ndërmarrjeve; | F | |
| **Neni 7 (3) (c)** | (c) çdo shpërblim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ngarkuar për përdorimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online ose të motorëve të kërkimit online përkatës; | 01 | Neni 12, pika 3, shkronja "c" | c) çdo shpërblim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ngarkuar për përdorimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online ose të motorit të kërkimit online; | F | |
| **Neni 7 (3) (d)** | (d) qasjen, kushtet ose çdo shpërblim të drejtpërdrejtë a të tërthortë të ngarkuar për përdorimin e shërbimeve, të funksionaliteteve ose të ndërfaqeve teknike që janë të rëndësishme për përdoruesin e biznesit ose për përdoruesin e faqes së internetit të ndërmarrjes dhe që lidhen drejtpërdrejt ose në mënyrë ndihmëse me përdorimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online ose të motorëve të kërkimit online përkatës. | 01 | Neni 12, pika 3, shkronja "ç" | ç) qasjen, kushtet ose çdo shpërblim të drejtpërdrejtë a të tërthortë të ngarkuar për përdorimin e shërbimeve, të funksionaliteteve ose të ndërfaqeve teknike që janë të rëndësishme për përdoruesin e biznesit ose për përdoruesin e faqes së internetit të ndërmarrjes dhe që lidhen drejtpërdrejt ose në mënyrë ndihmëse me përdorimin e shërbimeve në fjalë. | F | |
| **Neni 8**<br>**Kushte kontraktuale të veçanta** | Për të siguruar që marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet ofruesve të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesve të biznesit të zhvillohen në mirëbesim dhe mbi bazën e trajtimit të drejtë, ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online: | 01 | Neni 9 | Për të siguruar që marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet ofruesve të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesve të biznesit të zhvillohen në mirëbesim dhe mbi bazën e trajtimit të drejtë, ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online: | F | |
| **Neni 8 (a)** | (a) nuk imponojnë ndryshime me efekt prapaveprues të kushteve të përgjithshme, përveçse kur ato kërkohen për respektimin e një | 01 | Neni 9, shkronja "a" | a) nuk imponon ndryshime me efekt prapaveprues të kushteve të përgjithshme, përveçse kur ato kërkohen për përmbushjen e | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | detyrimi ligjor ose rregullator, ose kur ndryshimet me efekt prapaveprues janë në dobi të përdoruesve të biznesit; | | | një detyrimi ligjor ose rregullator, ose kur ndryshimet me efekt prapaveprues janë në dobi të përdoruesve të biznesit; | | |
| **Neni 8 (b)** | (b) sigurojnë që kushtet e tyre të përgjithshme të përmbajnë informacion për kushtet në të cilat përdoruesit e biznesit mund ta zgjidhin marrëdhënien kontraktuale me ofruesin e shërbimeve të ndërmjetësimit online; dhe | 01 | Neni 9, shkronja "b" | b) siguron që kushtet e tij të përgjithshme të përmbajnë informacion për kushtet, në të cilat përdoruesit e biznesit mund ta zgjidhin marrëdhënien kontraktuale me ofruesin; | F | |
| **Neni 8 (c)** | (c) përfshijnë në kushtet e tyre të përgjithshme një përshkrim të qasjes teknike dhe kontraktuale, ose të mungesës së saj, në informacionin e dhënë ose të gjeneruar nga përdoruesi i biznesit, të cilin e ruajnë pas mbarimit të kontratës ndërmjet ofruesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesit të biznesit. | 01 | Neni 9, shkronja "c" | c) përfshin në kushtet e tij të përgjithshme një përshkrim të qasjes teknike dhe kontraktuale, ose të mungesës së saj, në informacionin e dhënë ose të gjeneruar nga përdoruesi i biznesit, të cilin ofruesi e ruan pas mbarimit të kontratës ndërmjet tij dhe përdoruesit të biznesit. | F | |
| **Neni 9 (1)**<br>**Qasja në të dhëna** | 1. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online përfshijnë në kushtet e tyre të përgjithshme një përshkrim të qasjes teknike dhe kontraktuale, ose të mungesës së saj, të përdoruesve të biznesit në çdo të dhënë personale ose të dhënë tjetër, ose në të dyja, që përdoruesit e biznesit ose konsumatorët japin për përdorimin e shërbimeve përkatëse të ndërmjetësimit online ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve. | 01 | Neni 13, pika 1 | 1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online përfshin në kushtet e tij të përgjithshme një përshkrim të qasjes teknike dhe kontraktuale, ose të mungesës së saj, të përdoruesve të biznesit në çdo të dhënë personale ose të dhënë tjetër, ose në të dyja, që përdoruesit e biznesit ose konsumatorët japin për përdorimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve. | F | |
| **Neni 9 (2)** | 2. Nëpërmjet përshkrimit të përmendur në paragrafin 1, ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online i informojnë në mënyrë të përshtatshme përdoruesit e biznesit, në veçanti, për sa vijon: | 01 | Neni 13, pika 2 | 2. Nëpërmjet përshkrimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ofruesi i informon në mënyrë të përshtatshme përdoruesit e biznesit, në veçanti, për sa vijon: | F | |
| **Neni 9 (2) (a)** | (a) nëse ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online ka qasje në të dhënat personale ose në të | 01 | Neni 13, pika 2, shkronja "a" | a) nëse ofruesi ka qasje në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, që | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | dhënat e tjera, ose në të dyja, që përdoruesit e biznesit ose konsumatorët japin për përdorimin e këtyre shërbimeve ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të tyre, dhe, kur po, në cilat kategori të dhënash dhe në cilat kushte; | | | përdoruesit e biznesit ose konsumatorët japin për përdorimin e shërbimeve ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të tyre dhe, kur po, në cilat kategori të dhënash dhe në cilat kushte; | | |
| **Neni 9 (2) (b)** | (b) nëse një përdorues biznesi ka qasje në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, të dhëna nga ky përdorues biznesi në lidhje me përdorimin prej tij të shërbimeve përkatëse të ndërmjetësimit online ose të gjeneruara nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve për këtë përdorues biznesi dhe për konsumatorët e mallrave ose të shërbimeve të tij, dhe, kur po, në cilat kategori të dhënash dhe në cilat kushte; | 01 | Neni 13, pika 2, shkronja "b" | b) nëse përdoruesi i biznesit ka qasje në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, që jep vetë në lidhje me përdorimin e shërbimeve ose që gjenerohen nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për të dhe për konsumatorët e mallrave ose të shërbimeve të tij dhe, kur po, në cilat kategori të dhënash dhe në cilat kushte; | F | |
| **Neni 9 (2) (c)** | (c) përveç shkronjës (b), nëse një përdorues biznesi ka qasje në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, përfshirë në formë të agreguar, të dhëna ose të gjeneruara nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit online për të gjithë përdoruesit e biznesit dhe konsumatorët e tyre, dhe, kur po, në cilat kategori të dhënash dhe në cilat kushte; dhe | 01 | Neni 13, pika 2, shkronja "c" | c) përveç shkronjës "b" të kësaj pike, nëse përdoruesi i biznesit ka qasje në të dhënat personale ose në të dhënat e tjera, ose në të dyja, përfshirë në formë të përmbledhur, që jepen ose gjenerohen nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për të gjithë përdoruesit e biznesit dhe për konsumatorët e tyre dhe, kur po, në cilat kategori të dhënash dhe në cilat kushte; | F | |
| **Neni 9 (2) (d)** | (d) nëse ndonjë e dhënë sipas shkronjës (a) u jepet palëve të treta, së bashku me, kur dhënia e këtyre të dhënave palëve të treta nuk është e nevojshme për funksionimin e duhur të shërbimeve të ndërmjetësimit online, informacionin që specifikon qëllimin e kësaj ndarjeje të të dhënave, si dhe mundësitë e përdoruesve të biznesit për të mos e lejuar këtë ndarje. | 01 | Neni 13, pika 2, shkronja "ç" | ç) nëse të dhënat e parashikuara në shkronjën "a" të kësaj pike u jepen palëve të treta, së bashku me qëllimin e dhënies së tyre dhe me mundësitë e përdoruesit të biznesit për të mos e lejuar këtë dhënie, kur ajo nuk është e nevojshme për funksionimin e duhur të shërbimeve të ndërmjetësimit online. | F | |

| Acquis i BE-së: **Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | Legjislacioni shqiptar i propozuar **01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| **Neni 9 (3)** | 3. Ky nen nuk cenon zbatimin e Rregullores (BE) 2016/679, të Direktivës (BE) 2016/680 dhe të Direktivës 2002/58/KE. | 01 | Neni 13, pika 3 | 3. Ky nen nuk cenon zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. | F | |
| **Neni 10 (1)**<br>**Kufizimet për të ofruar kushte të ndryshme me mjete të tjera** | 1. Kur, gjatë ofrimit të shërbimeve të tyre, ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online kufizojnë aftësinë e përdoruesve të biznesit për t'u ofruar konsumatorëve të njëjtat mallra dhe shërbime me kushte të ndryshme, me mjete të tjera nga këto shërbime, ata përfshijnë arsyet e këtij kufizimi në kushtet e tyre të përgjithshme dhe i vënë këto arsye lehtësisht në dispozicion të publikut. Këto arsye përfshijnë konsideratat kryesore ekonomike, tregtare ose ligjore për këto kufizime. | 01 | Neni 14, pika 1 | 1. Kur ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online, gjatë ofrimit të shërbimeve të tij, kufizon aftësinë e përdoruesve të biznesit për t'u ofruar konsumatorëve të njëjtat mallra dhe shërbime me kushte të ndryshme, me mjete të tjera nga këto shërbime, ai përfshin arsyet e këtij kufizimi në kushtet e tij të përgjithshme dhe i vë ato lehtësisht në dispozicion të publikut. Arsyet përfshijnë konsideratat kryesore ekonomike, tregtare ose ligjore për kufizimin. | F | |
| **Neni 10 (2)** | 2. Detyrimi i përcaktuar në paragrafin 1 nuk prek asnjë ndalim ose kufizim për vendosjen e kufizimeve të tilla, që rrjedh nga zbatimi i akteve të tjera të së drejtës së Bashkimit ose i së drejtës së shteteve anëtare që është në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe të cilës i nënshtrohen ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online. | 01 | Neni 14, pika 2 | 2. Detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk cenon asnjë ndalim ose kufizim për vendosjen e kufizimeve të tilla, që rrjedh nga zbatimi i legjislacionit në fuqi, përfshirë legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës dhe atë për praktikat e padrejta tregtare. | F | |
| **Neni 11 (1)**<br>**Sistemi i brendshëm i trajtimit të ankesave** | 1. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online parashikojnë një sistem të brendshëm për trajtimin e ankesave të përdoruesve të biznesit.<br>Ky sistem i brendshëm i trajtimit të ankesave është lehtësisht i qasshëm dhe pa pagesë për përdoruesit e biznesit dhe siguron trajtimin brenda një afati të arsyeshëm. Ai bazohet në parimet e transparencës dhe të trajtimit të barabartë në situata të barasvlershme, si dhe në trajtimin e ankesave në mënyrë proporcionale me rëndësinë dhe kompleksitetin e tyre. Ai u mundëson përdoruesve të biznesit të paraqesin | 01 | Neni 15, pika 1;<br>Neni 15, pika 2;<br>Neni 15, pika 3 | 1. Ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online ngre një sistem të brendshëm për trajtimin e ankesave të përdoruesve të biznesit. Sistemi është lehtësisht i qasshëm dhe pa pagesë për përdoruesit e biznesit.<br>2. Sistemi i përmendur në pikën 1 të këtij neni siguron trajtimin e ankesave brenda një afati të arsyeshëm. Ai bazohet në parimet e transparencës dhe të trajtimit të barabartë në situata të ngjashme si dhe në trajtimin e tyre në mënyrë proporcionale me rëndësinë dhe kompleksitetin e tyre. | F | |

| Acquis i BE-së:<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | Legjislacioni shqiptar i propozuar<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | ankesa drejtpërdrejt te ofruesi përkatës në lidhje me ndonjë nga çështjet e mëposhtme: | | | 3. Sistemi i brendshëm i trajtimit të ankesave i mundëson përdoruesit të biznesit paraqitjen direkte te ofruesi të ankesës në lidhje me: | | |
| **Neni 11 (1) (a)** | (a) mospërmbushjen e pretenduar nga ky ofrues të ndonjë detyrimi të përcaktuar në këtë Rregullore, që ndikon te përdoruesi i biznesit që paraqet ankesën ("ankuesi"); | 01 | Neni 15, pika 3, shkronja "a" | a) mospërmbushjen e pretenduar nga ofruesi të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, që ndikon te ankuesi; | F | |
| **Neni 11 (1) (b)** | (b) çështjet teknologjike që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe që ndikojnë te ankuesi; | 01 | Neni 15, pika 3, shkronja "b" | b) çështjet teknologjike që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe që ndikojnë te ankuesi; | F | |
| **Neni 11 (1) (c)** | (c) masat e marra nga ky ofrues ose sjelljen e tij, që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe që ndikojnë te ankuesi. | 01 | Neni 15, pika 3, shkronja "c" | c) masat e marra ose sjelljen e ofruesit, që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe që ndikojnë te ankuesi. | F | |
| **Neni 11 (2)** | 2. Si pjesë e sistemit të tyre të brendshëm të trajtimit të ankesave, ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online: | 01 | Neni 15, pika 4 | 4. Si pjesë e sistemit të brendshëm të trajtimit të ankesave, ofruesi: | F | . |
| **Neni 11 (2) (a)** | (a) shqyrtojnë me kujdes ankesat e paraqitura dhe masat e ndjekjes që mund t'u duhet t'i japin ankesës për të trajtuar në mënyrë të përshtatshme çështjen e ngritur; | 01 | Neni 15, pika 4, shkronja "a" | a) shqyrton me kujdes ankesat e paraqitura dhe masat e ndjekjes që mund të jenë të nevojshme për zgjidhjen e duhur të çështjes së ngritur; | F | |
| **Neni 11 (2) (b)** | (b) i përpunojnë ankesat shpejt dhe në mënyrë efektive, duke marrë parasysh rëndësinë dhe kompleksitetin e çështjes së ngritur; | 01 | Neni 15, pika 4, shkronja "b" | b) i përpunon ankesat shpejt dhe në mënyrë efektive, duke marrë parasysh rëndësinë dhe kompleksitetin e tyre; | F | |
| **Neni 11 (2) (c)** | (c) i komunikojnë ankuesit rezultatin e procesit të brendshëm të trajtimit të ankesave, në mënyrë të individualizuar dhe të hartuar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. | 01 | Neni 15, pika 4, shkronja "c" | c) i komunikon ankuesit, në mënyrë të individualizuar dhe në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, rezultatin e procesit të brendshëm të trajtimit të ankesës. | F | |
| **Neni 11 (3)** | 3. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online japin në kushtet e tyre të përgjithshme të gjithë | 01 | Neni 15, pika 5 | 5. Ofruesi përfshin në kushtet e tij të përgjithshme të gjithë informacionin e | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | informacionin përkatës në lidhje me qasjen në sistemin e tyre të brendshëm të trajtimit të ankesave dhe me funksionimin e tij. | | | nevojshëm për aksesin në sistemin e brendshëm të trajtimit të ankesave dhe për funksionimin e tij. | | |
| **Neni 11 (4)** | 4. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online hartojnë dhe vënë lehtësisht në dispozicion të publikut informacion për funksionimin dhe efektivitetin e sistemit të tyre të brendshëm të trajtimit të ankesave. Ata e verifikojnë informacionin të paktën një herë në vit dhe, kur nevojiten ndryshime të rëndësishme, e përditësojnë atë.<br>Ky informacion përfshin numrin e përgjithshëm të ankesave të paraqitura, llojet kryesore të ankesave, kohën mesatare të nevojshme për përpunimin e ankesave dhe informacion të agreguar për rezultatin e ankesave. | 01 | Neni 15, pika 6 | 6. Ofruesi harton dhe vë lehtësisht në dispozicion të publikut informacionin për funksionimin dhe efektivitetin e sistemit të tij të brendshëm të trajtimit të ankesave. Ai e verifikon këtë informacion të paktën një herë në vit dhe e përditëson atë kur nevojiten ndryshime të rëndësishme. Informacioni përmban numrin e përgjithshëm të ankesave të paraqitura, llojet kryesore të ankesave, kohën mesatare të nevojshme për përpunimin e tyre dhe informacion të përmbledhur për rezultatin e ankesave. | F | |
| **Neni 11 (5)** | 5. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online që janë ndërmarrje të vogla në kuptim të Aneksit të Rekomandimit 2003/361/KE. | 01 | Neni 15, pika 7 | 7. Ky nen nuk zbatohet, kur ofruesi i shërbimitështëndërmarrje e vogël ose mikrondërmarrje, sipas ligjit nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”. | F | |
| **Neni 12 (1)**<br>**Ndërmjetësimi** | 1. Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online identifikojnë në kushtet e tyre të përgjithshme dy ose më shumë ndërmjetës, me të cilët janë të gatshëm të angazhohen për të tentuar arritjen e një marrëveshjeje me përdoruesit e biznesit për zgjidhjen jashtëgjyqësore të çdo mosmarrëveshjeje ndërmjet ofruesit dhe përdoruesit të biznesit, që lind në lidhje me ofrimin e shërbimeve përkatëse të ndërmjetësimit online, përfshirë ankesat që nuk kanë mundur të zgjidhen nëpërmjet sistemit të brendshëm të trajtimit të ankesave të përmendur në nenin 11. | 01 | Neni 16, pika 1;<br>Neni 16, pika 2 | 1. Për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online identifikon në kushtet e tij të përgjithshme dy ose më shumë ndërmjetës, nga lista e ndërmjetësve të<br>licencuar dhe regjistruar, pranë Ministrisë së Drejtësisë sipas legjislacionit në fuqi për ndërmjetësimin, me të cilët është i gatshëm të angazhohet për të arritur një marrëveshje me përdoruesit e biznesit për zgjidhjen jashtëgjyqësore të çdo mosmarrëveshjeje ndërmjet ofruesit dhe përdoruesit të biznesit, që lind në lidhje me ofrimin e shërbimeve të | F | |

| **Acquis i BE-së:**<br>**Rregullorja (BE) 2019/1150 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Numri CELEX: 32019R1150, Fletorja Zyrtare L 186, 11.7.2019, f. 57–79** | | **Legjislacioni shqiptar i propozuar**<br>**01 – Projektligji "Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit" (krerët I–V, varianti i 14.9.2026)**<br><br>F – përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** |
| **Neni** | **Teksti** | **Referenca** | **Neni** | **Teksti** | **Përputhshmëria** | **Shënime** |
| | Ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online mund të identifikojnë ndërmjetës që ofrojnë shërbimet e tyre të ndërmjetësimit nga një vend jashtë Bashkimit vetëm kur sigurohet që përdoruesit e biznesit të prekur të mos privohen efektivisht nga përfitimi i çdo garancie ligjore të përcaktuar në të drejtën e Bashkimit ose në të drejtën e shteteve anëtare, si pasojë e ofrimit të këtyre shërbimeve nga ndërmjetësit jashtë Bashkimit. | | | ndërmjetësimit online, përfshirë ankesat që nuk kanë mundur të zgjidhen nëpërmjet sistemit të brendshëm të trajtimit të ankesave, të parashikuar në nenin 15 të këtij ligji.<br>2. Në identifikimin e ndërmjetësve sipas pikës 1 të këtij neni, ofruesi i shërbimit mban parasysh përmbushjen e kërkesave të legjislacionit në fuqi për ndërmjetësimin. | | |
| **Neni 12 (2)** | 2. Ndërmjetësit e përmendur në paragrafin 1 plotësojnë kërkesat e mëposhtme: | 01 | Neni 16, pika 2 | 2. Në identifikimin e ndërmjetësve sipas pikës 1 të këtij neni, ofruesi i shërbimit mban parasysh përmbushjen e kërkesave të legjislacionit në fuqi për ndërmjetësimin. | PPj | Kërkesat e shkronjave (a)–(f) zëvendësohen me referim të përgjithshëm ne draft ligj me legjislacionin për ndërmjetësimin (ligji nr. 10385/2011, i ndryshuar), i cili përcakton rregullat dhe parimet për ndërmjetësimin. |
